




Qershor 2013 – Dhjetor 2014

Raport | Aktiviteteve



PARATHËNIE

Dy vitet e fundit kanë qenë një periudhë tejet intensive për Ambasadën PINK dhe për lëvizjen LGBTI në Shqipëri. Brenda një kohe të shkurtër u realizuan të parat aktivitete publike në mjedise të hapura të tilla si Festivali i Diversitetit apo Parada e Krenarisë, e cila u zhvillua për herë të parë në 17 Maj 2014. Nën-komisioni për të Drejtat e Njeriut në Parlamentin e Shqipërisë mbajti të parën seancë dëgjimore mbi tematikën dhe komunitetin LGBTI. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë përmbylli të parën iniciativë për mbrojtjen e personave LGBTI nga diskriminimi dhe aktualisht është duke punuar për një plan të ri masash. Ndërkohë e njëjta Ministri ka përfshirë gjerësisht komunitetin LGBT në Planin Strategjik për Përfshirjen Sociale të viteve 2015-2020. Gjashtë Bashki të vendit, të Tiranës, Durrësit, Elbasanit, Korçës, Shkodrës dhe Vlorës kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me organizatën tonë për luftimin e diskriminimit në nivel lokal. Institucione të shumta kombëtare, organizata vendase e të huaja, miq e partnerë të kauzës LGBTI janë përfshirë në aktivitete të shumta që kanë synuar integrimin e kësaj tematike në nivel institucional, njohjen e problemeve dhe nevojave të komunitetit dhe adresimin e duhur të tyre. Avokati i Popullit publikoi një raport të veçantë për cilësinë e shërbimeve mjekësore ndaj personave LGBTI ndërsa Komisioneri për Mbrojtjen kundër Diskriminimit publikoi një raport të veçantë mbi këtë komunitet. Ministria e Arsimit ka pranuar të vlerësojë situatën me diskriminimin dhe bulizmin homofobik në shkolla dhe ta trajtojë atë si çështje. Së fundmi në Tiranë është hapur një qendër emergjence / strehëz për komunitetin LGBTI. Gjithashtu, Tirana ka tashmë të parin club nate që funksionon mirëfilli për komunitetin LGBT, duke i dhënë ngjyrat, argëtimin dhe hapësirën e sigurtë kaq të munguar dhjetra të rinjve dhe të rejave LGBT nga i gjithë vendi.

Por pavarësisht këtyre zhvillimeve pozitive, problemet me diskriminimin, krimet dhe fjalimet homofobike e transfobike mbeten të mëdha. Të rinj LGBTI vazhdojnë të kontaktojnë organizatën tonë për të raportuar sulme homofobike, probleme në

familje si dhe shpesh kërkojnë ndihmë apo asistencë për tu larguar nga vendi. Fjalimet homofobike dhe urrejtja ndaj komunitetit vazh

don të mbetet një problem i madh. Pas aktiviteteve ndërgjegjësuere të 17 Majit 2014, deklaratat, sulmet në media sociale dhe fjalimet e urrejtjes ishin të shumta. Më e veçanta dhe shqetësuesja ndër to ishte një i ashtu-quajtur peticion i 57 intelektualëve me titullin “Familje e shëndoshe, atdhe i shëndoshë”. Sipas deklaratave të disa prej personave të përfshirë në këtë peticion, ata nuk kishin firmosur asnjë peticion të tillë dhe se emri i tyre ishte vendosur aty pa konfirmimin e tyre. Ambasada PINK ka dorëzuar një ankesë pranë Prokurorisë së Tiranës duke kërkuar hetimin e këtij rasti. Problemet me raportimin jo-etik të tematikës LGBT në mediat shqiptare mbeten shumë të medha dhe mjaft të vështira për tu adresuar. Gjuha e përdorur në media nga personazhe publikë, keqinformimi, skandalizimi i tematikës LGBTI mbetet një çështje kryesore. Personat LGBT vuajnë nga shërbime të dobëta mjekësore dhe psikologjike, duke qenë se sistemi mjekësor shqiptar është shumë i papërgatitur për adresimin e nevojave dhe problemeve të këtij komuniteti.

Si përfundim, dy vitet e fundit kanë qenë inkurajuese për kauzën LGBT në Shqipëri pavarësisht se sfidat dhe puna për arritjen e barazisë së plotë të këtij komuniteti janë të shumta e të vështira. Siç thotë edhe shprehja e famshme e astronautit Neil Armstrong, “një hap i vogël për një njeri, një hap gjigand për njerëzimin”, ne besojmë se hapat e vegjël individualë të marrë nga të gjithë ne në të mirë të kësaj kauze, do arrijnë të reflektohen në një shoqëri më të hapur, tolerante e respektuese për brezat në vazhdim.

Punë të mbarë dhe faleminderit për mbeshtetjen!

Amarildo Fecanji
Drejtor Programesh

AKTIVITETET



Nisi zbatimin e iniciativës “**Përmirësimi i jetës së personave LGBT në nivel lokal**” (2014-2016) në bashkëpunim me Avokatin e Popullit dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me mbështetjen e Bashkimit Europian dhe pjesëmarrjen e Bashkive Tiranë, Durrës, Elbasan, Vlorë, Korçë dhe Shkodër si dhe Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Nënshkruan Marrëveshje Bashkëpunimi me Bashkitë e gjashtë qyteteve dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Avokatin e Popullit.



Organizoi **Paradën e Parë të Krenarisë në Tiranë**, 17 Maj 2014, në bashkëpunim me Shtëpinë e të Drejtave të Njeriut në Shqipëri dhe Open Mind Spectrum Albania dhe mbështetjen e dhjetra institucioneve dhe organizatave vendase dhe të huaja. Mori pjesë në Paradat e Krenarisë të Beogradit dhe Selanikut për vitin 2014.



U vlerësua me çmimin **ACT Now!** nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara për “përpjekjet e organizatës në mbrojtje të të drejtave LGBT dhe në luftën kundër diskriminimit të personave LGBT”.



Zhvilloi takime pune me zyrtarë të lartë të vendit si Z. Erjon Veliaj, Ministër i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Znj. Nora Malaj, Zv. Ministre e Arsimit dhe Sportit, Znj. Milva Ikonimi, Zv. Ministre e Shëndetësisë, Znj. Elona Gjebrea Zv. Ministre e Brendshme, Znj. Nevila Xhindi, nën Kryetare e Bashkisë Tiranë, Z. Vangjush Dako, Kryetar i Bashkisë Durrës, Z. Niko Peleshi, ish-Kryetar i Bashkisë Korçë, aktualisht Zv. Kryeministër i Shqipërisë, Z. Qazim Sejdiu, Kryetar i Bashkisë Elbasan, Z. Shpëtim Gjika, Kryetar i Bashkisë Vlorë, Nën-komisionin e të Drejtave të Njeriut të Kuvendit të Shqipërisë etj.



Mori pjesë në **takime pune me zyrtarë të lartë ndërkombëtarë** brenda dhe jashtë Shqipërisë si Z. Nils Muižnieks, Komisioner për të Drejtat e Njeriut pranë Këshillit të Europës, Z. Štefan Füle, Komisioner për Zgjerimin dhe Politikën e Fqinjësisë të Bashkimit Europian, Z. Aleksandër Arvizu, Ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë etj.



Zhvilloi takime pune për tematikën LGBT me Avokatin e Popullit Z. Igli Totozani, Komisioneren për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Znj. Irma Baraku, Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ambasadat e Vendeve të Ulëta, SHBA, Suedisë etj organizata si Civil Rights Defenders, Kvinna till Kvinna, organizatat dhe institucionet mbështetëse të Festivalit të Diversitetit 2014, Assist Impact, NDI etj.



Mori pjesë si paneliste dhe **përfaqësuese e kauzës LGBT në konferenca, seminare dhe aktivitete** të organizuara brenda dhe jashtë Shqipërisë nga Këshilli i Europës (Strasburg & Tiranë), Komisioni Europian (Tiranë, Bruksel & Beograd), Forumi i Pjesëmarrjes së të Rinjve në Politikë dhe Forumi i Aktivistëve për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut pranë OSBE/ODIHR (Varshavë & Stamboll), Banka Botërore (Washington), Kombet e Bashkuara (UNFPA, UNDP, UNICEF etj), Kvinna till Kvinna (Stamboll), Heinrich Ball Stiftung (Berlin),

Open Society Foundation (Barcelon), Rrjeti Norvegjez i Organizatave Rinore dhe Rinia Shqiptare në Norvegji (Tiranë), Liderishipi i të Rinjve të Tiranës (Tiranë), Fushata kundër fjalimeve të Urrejtjes e Këshillit të Europës (Tiranë, Strasburg, Budapest), Konferencën Vjetore të të drejtave të Njeriut (Avokati i Popullit, Tiranë), Konferencën mbi diskriminimin e shumëfishtë (Strasburg), konferenca dhe takime pune të TACSO (Tiranë), Eventin “Welcome to the game” nga RVSH, FYA dhe Brave New Generation, Konferenca e BE “Të drejtat themelore, mos-diskriminimi dhe mbrojtja e grupeve vulnerabël, përfshi LGBTI (Tiranë), Konferencën Vjetore të Avokatit të Popullit (Tiranë), Trajnimi mbi njohjen ligjore të personave trans zhvilluar nga Avokati i Popullit dhe Këshilli i Europës (Tiranë), Panairi i organizatave të shoqërisë civile (Shkodër), takim mbi promovimin e turizmit për komunitetin LGBT me Agjencinë Kombëtare të Turizmit (Tiranë), Workshop për Sindikatat e Shqipërisë mbi tematikën LGBTI (Tiranë) etj.



Mori pjesë si paneliste ose përfaqësuese në **konferenca, seminare, trajnime, iniciativa dhe aktivitete të tjera** të organizuara nga organizata LGBT vendase dhe ndërkombëtare të tilla si ILGA Europe, takimi strategjik vjetor (Athinë) dhe Konferenca Vjetore (Riga), IGLYO, Asambleja e Përgjithshme Vjetore (Dublin) dhe Konferenca mbi interseksionalitetin (Bolonjë), Rrjeti BABELNOR (Europa Nordike dhe Lindore, Sarajevë), Rrjeti Rajonal kundër Homofobisë dhe Transfobisë (Turqi), Thessaloniki Pride (Selanik), Labris (Serbi), Rrjeti Mesdhetar LGBT (Maltë), themelimin e Rrjetit Ndërfetar Global (Afrikë e Jugut), Global Opportunities Albania (Tiranë), Open Society Foundation SOROS (Tiranë), Aleanca kundër Diskriminimit LGBT (Tiranë), Panairin e Organizatave të Shoqërisë Civile (Përtej Barrierave – Tiranë), përdorimi i indikatorëve për të matur të drejtat e njeriut në Shqipëri (Avokati i Popullit), trajnim mbi komunikimin dhe zhvillimin e komunitetit (ILGA Europe, Budapest), Seminarin mbi luftimin e fjalimeve të urrejtjes me bazë homofobinë dhe transfobinë (Budapest), Queer Easter – Aktivizmi Queer dhe Socialist (Berlin), takime lobuese për tematikën LGBT pranë institucioneve kryesore të Bashkimit Europian (Bruksel), fushata #Greetingsfrom (BABELNOR), planin e punës së rrjetit BABELNOR (Ljubjanë), takim koordinues mes organizatave LGBTI nga Kosova, Maqedonia dhe Shqipëria (Prishtinë) etj.



Zhvilloi **trajnime, seminare, workshope, prezantime e aktivitete** për Policinë e Shtetit (KiE, PINK in Blue Hollandë dhe COC Hollandë); Universitetin e Tiranës (Fakulteti i Shkencave Sociale) dhe disa Universitete private (UNYT dhe UFO); 15 trajnime të diversitetit në shkolla të mesme nga i gjithë vendi (Korpusi i Paqes dhe PINK); punonjës të Ministrive të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Shëndetësisë, Arsimit, Ministrisë së Punëve të Brendshme etj, janë trainuar mbi diversitetin dhe çështjet LGBTI; kurse piktur bashkëkohore (TiranaAkt me aktivistë nga Berlini); kurse trainimi janë zhvilluar me punonjës të administratës së gjashtë Bashkive (Tiranë, Durrës, Elbasan, Vlorë, Korçë, Shkodër); shfaqje filmash me tematikë të drejtat LGBT për komunitetin në bashkëpunim me institucione si Ambasada e Holandës, SHBA-ve dhe Izraelit (Tiranë); ekspozitën “Shija e Lirisë” pranë Club La Garcionere, (Tiranë), EU Info Centre (Shkodër) dhe Qendra Tirana Express (Tiranë); trajnim mbi kauzën LGBT me 30 aktivistë nga Rrjeti i Vullnetarëve Shqiptarë (Tiranë); Fokus Grup me vajza LBT në kuadër të 16 ditëve kundër dhunës me bazë gjinore të MMRS (Tiranë), stafin e Korpusit të Paqes (Tiranë) etj.



Paraqiti **komente, materiale kërkimore, analiza, informacion dhe asistoi institucionet** për: planin e Masave të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për mosdiskriminimin për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, mbi kapacitetet e ofruesve të shërbimeve sociale, ndryshimet në kodin penal dhe kodin e familjes (MMSR), raportet vjetore mbi situatën LGBT në Shqipëri (ILGA Europe), Raportet Speciale për komunitetin LGBT, të Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për hartën e organizatave rinore shqiptare (UNICEF), mbrojtjen e refugjatëve dhe personave pa shtetësi (Ambasada e Francës), planet strategjike të ILGA Europe dhe IGLYO, raportet e shkeljeve të të drejtave të njeriut si dhe mbi krimet e urrejtjes pranë OSBE-ODIHR, Raportin Periodik Universal të Kombeve të Bashkuara, fokus grupe me të rinjtë LGBT

mbi aksesin në shërbime shëndetësore (UNFPA Tiranë), situatën ligjore dhe sociale të komunitetit transgjnor për Transgender Europe (TGEU - Berlin), situatën e komunitetit LGBT për Komitetin Europian Ekonomik dhe Social (EESC), komente për Axhendën Post-2015 (UNDP Tiranë), kërkimin shkencor mbi cilësinë e shërbimeve shëndetësore për personat LGBT në Shqipëri (Këshilli i Europës & Avokati i Popullit), Planin e Veprimit të Rinjve të Tiranës, debatin mbi martesat e gjinisë së njëjtë (Avokati i Popullit, Tiranë), vlerësimin e organizatave LGBT nga Assist Impact (Tiranë), komente mbi projektligjin për informimin publik (Ministria e Inovacionit), Partnerë Socialë – Koha për veprim, forcimi i bashkëpunimit qeveri-shoqëri civile (Partners Albania, Tiranë), informacion mbi LGBT për departamentin e Psikologjisë pranë Universitetit Vitrina, kontributin e shoqërisë civile për integrimin në Bashkimin Europian (Ministria e Integritit), komente mbi tematikën LGBT për Seksionin e Ballkanit Perëndimor të Agjencisë së Marrëdhënieve të Jashtme të Bashkimit Europian (EEAS), Rolin e OJF-ve në promovimin e sipërmarrjes sociale në Shqipëri (TACSO), praktikat e mira të Ambasadës PINK për faqen zyrtare online të Avokatit të Popullit, Raportin Vjetor të Shkeljeve të Drejtave të Njeriut (OSBE/ODIHR), përmbledhje e situatës së komunitetit LGBT në Shqipëri për portalin Euro Queer, komente dhe informacion për Manualin për personat LGBTI “Të lirë dhe të Barabartë” (Partnerë për Fëmijët), Raportin Vjetor të Departamentit Amerikan të Shtetit (Ambasada e SHBA), seminarin kombëtar të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për aspekte ligjore dhe problematikat e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi etj.



Organizoi Javën e Diversitetit (12-17 Maj) në Kuadër të Ditës Ndërkombëtare kundër Homofobisë dhe Transfobisë (IDAHOT). Aktivitetet e realizuara në kuadër të javës ishin:

- Konferenca hapëse e Festivalit dhe lançimi i videos “Thuaj Po Dashurisë”
- Festivali i Filmit LGBT, në bashkëpunim me Akademinë e Filmit dhe Multimedias Marubi, Ambasadën e SHBA-ve, Britanisë së Madhe;
- Shfaqja e Filmit “Dy herë prindër / Due Volte Genitori” e organizatës italiane AGEDO, në bashkëpunim me Ambasadën e Italisë në Tiranë dhe pjesëmarrjen e AGEDO dhe Certi Diritti;
- Ekspozita e fotografisë “Qyteti i Ngjyrave” pranë Pallatit të Kulturës së Durrësit, në bashkëpunim me Bashkinë Durrës;
- Takim me prindërit e personave LGBTI në bashkëpunim me Open Mind Spectrum Albania;
- Festat “Together at the Party” dhe “Pride Party” pranë Club La Garconniere;
- Panairi i Diversitetit pranë Sheshit “Vëllezërit Frashëri”;



Mirëpriti dhe lehtësoi organizimin e Seminarit Ndërkombëtar **“I/E lirë për tu shprehur – të luftosh fjalimet e urrejtjes homofobike dhe transfobike”** për Rrjetin Ndërkombëtar të Organizatave LGBT, BABELNOR, me pjesëmarrjen e mbi 30 të rinjve LGBT nga e gjithë Europa në Shqipëri.

PUBLIKOI

- o 2 Raporte Vjetore për Shkeljen e të Drejtave të Njeriut
- o Broshurën: “Fletë informuese për zyrtarët publikë mbi çështjet LGBT”;
- o Broshurën “Të dalësh nga dollapi”: Te jetosh hapur si person LGBT”;
- o Broshurën online “Një udhërrëfyes për daljen hapur” në bashkëpunim me Human Rights Campaign;
- o Broshurën: “Seksi i sigurtë është Përgjesia e Gjithkujt”
- o Videon promocionale kundër fjalimeve të urrejtjes “Thuaj Po dashurisë”;
- o Kartolinën “Tirana Pride 2014”;
- o Fushatën “Access all Areas” të Transgender Europe;
- o Posterin “Thuaj PO Dashurisë”;

URREJTJA NUK ËSHTË ZGJIDHJA!

**THUAJ
P
DASHURISË!**



12-17 MAJ 2014, FESTIVALI 3-të I DIVERSITETIT
17 MAJ 2014, MARSHIMI 1-1-rë I KRENARISË (1st TIRANA PRIDE)



**TIRANA
PRIDE
2014
MAJ 17 MAY**

**TË
DALËSH
NGA
“DOLLAPI”**

Te jetosh hapur si person LGBT



PINK EMBASSY  **PLANETESHE E DIVERSITETIT**

**FLETË
INFORMUESE**

**PËR ZYRTARËT PUBLIK
MBI ÇËSHTJET LGBT**



LGBT    

**PINK EMBASSY
AMBASADA**

SEKSI

**I SIGURT
ËSHTË
PERGJEGJËSIA
E GJITHKUJT!**

PRO   

DENONCOI

- o Komentet homofobike dhe transfobike të politikanëve shqiptarë;
- o Gjykimin e padrejtë të një personi trangjinorë;
- o Peticionin e rremë të 57 intelektualëve “Familje e Shëndoshë, Atdhe i Shëndoshë” dhe bëri kërkesë për hetim të çështjes pranë Prokurorisë së Tiranës;



Mbështeti publikisht dhe u përfshi në **peticione, protesta, kërkesa, ankesa, aktivitete** etj, në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut në Shqipëri dhe jashtë si: ligjin e abortit në Maqedoni, protestat e Gizi Park në Stamboll, moszbatimin e kuotave gjinore në Shqipëri, problemet me zgjedhjet lokale të 23 Qershorit 2013, Paradën e Minskut, importin e armëve kimike nga Siria, pjesëmarrjen e grave në politikë, hapje teatri eksperimental në Shqipëri, Fushatën World Love – IDAHOT, Australi 2014, fjalimet e urrejtjes kundër personave LGBT nga politikanët shqiptarë në Maqedoni, përvjetorin e 5-të të ALO 116, ndryshimet kushtetuese në Maqedoni të cilat do të ndalonin të drejtën e martesës për çiftet e të njëjtit seks, lufta e dhunës kundër fëmijëve etj.



U bë pjesë e Bordit Rinor Këshillimor pranë Këshillit të Bashkisë së Tiranës



Dha intervista, kreu shfaqje mediatike dhe debate televizive-radiofonike për media vendase dhe të huaja në programme si **Takimi i Pasdites** në TV Klan, **One Morning** në Channel One, **Wake up** në Top Channel, **Tete a tete** në AI Report, **Programi i Pasdites** në Albanian Screen, **Programi i Pasdites** në News 24 etj.



Publikoi artikuj dhe deklarata në mediat e saj dhe i shpërndau gjerësisht në mediat kombëtare artikujt dhe deklaratat e mëposhtme:

- o Mesazh solidariteti me komunitetin LGBT dhe rininë turke;
- o Ambasada PINK raporton pranë BE mbi situatën e komunitetit LGBT në vend;
- o Politikanët të heqin dorë nga komentet homofobike dhe diskriminuese;
- o Intensifikohet dhuna kundër komunitetit LGBT në Maqedoni;
- o Ministrat e jashtëm të BE miratojnë planin LGBTI për politikën e jashtme;
- o Martesat homoseksuale nuk dëmtojnë martesat heteroseksuale;
- o Destinacionet më të mirat verore LGBT në Europë;
- o Dënimi i transgjinjorëve diskriminues dhe jo-proporcional;
- o Ndahen çmimet e konkursit të gazetarisë mbi çështjen LGBT;
- o Deklaratë në mbështetje të barazisë në martesë;
- o Ambasada PINK prezanton bizneset miqësore ndaj komunitetit LGBTI;
- o Në mbrojtje të fjalës së lire, arsimit dhe punësimit në pararojë të saj;
- o Ambasada PINK takohet me Bankën Botërore në Washington, për tematikën LGBT;

- o Prokuroria të hetojë peticionin “Familje e shëndoshë, atdhe i shëndoshë”;
- o Kur martesat e gjinisë së njëjtë ishin një rit i krishterë;
- o Qeveria të dëmshpërblejë personat LGBT të dënuar gjatë regjimit komunist;
- o Parlamenti kroat voton ligjin për bashkësitë civile;
- o Ambasada PINK vlerësohet me çmimin ACT Now;
- o Maqedoni: Parlamenti mund të ndalojë martesat e gjinisë së njëjtë në Kushtetutë;
- o Nis projekti i qyteteve miqësore për personat LGBT;
- o Qeveria shqiptare ti kërkojë Bankës Botërore të ndryshojë masat mbrojtëse për grupet vulnerabël;
- o Zhvillohet me sukses Parada e Beogradit;
- o Zhvillohet në Tiranë seminari ndërkombëtar për të rinjtë LGBT;
- o 6 të rinj aktivistë dhe studentë vlerësohen për mbështetjen e Seminarit Ndërkombëtar në Tiranë;
- o Deklaratë e Shoqërisë Civile mbi masat e Bankës Botërore;
- o Ndryshimi 33 i Kushtetutës së Maqedonisë cënon privatësinë dhe të drejtën për familje të personave LGBT;
- o PINK bëhet pjesë e Bordit Rinor Këshillimor pranë Këshillit të Bashkisë Tiranë;
- o PINK dënon sulmet kundër komunitetit LGBT në Maqedoni;
- o Publikohet online udhërrëfyese për daljen hapur;
- o Bashkitë angazhohen për mbrojtjen e të drejtave LGBT;
- o Ambasada PINK prezantohet në konferencën rajonale të BE;
- o Ambasada PINK i kërkon Parlamentit miratimin e ndryshimeve në Kodin e Familjes;
- o Festivali i Diversitetit: Një javë ndërjegjësimi për të drejtat e personave LGBT;



Publikoi faqen www.lgbtravelalbania.com për bizneset miqësore ndaj komunitetit LGBT, falë mbështetjes së Këshillit të Europës. Zhvilloi një fushatë të gjerë komunikimi me bizneset e vendit për të regjistruar aktivitetin e tyre në portal.



Pati mbi **15.200 vizita** në faqen www.pinkembassy.al me një mesatare prej 800 klikimesh në muaj dhe një rritje të dyfishtë të numrit të vizitorëve mujorë në periudhën Prill-Qershor 2014.



Informoi në mënyrë të përditshme **2348 përdorues** në grupin e PINK në rrjetin social Facebook.



U angazhua efektivisht me organizatat dhe rrjetet tek të cilat është anëtare, të tilla si:

- o ILGA Europe
- o IGLYO
- o Rrjeti BABELNOR
- o Euro Pride
- o Regional Network against Homophobia and Transphobia
- o Grup organizatash LGBTI nga Ballkani Perëndimor dhe Turqia për krijimin e një organizate rajonale LGBTI



Asistoi **anëtarë të komunitetit LGBT** në lidhje me shkelje të të drejtave të tyre nga familja, kërcënimet dhe dhunën kundër tyre, probleme emocionale, probleme në familje e shkolla, informacion mbi të drejtën për azil, etj;



Zhvilloi **takime me komunitetin LGBT** për forcimin e aleancave midis personave LGBTI dhe atyre straight, organizimin e aktiviteteve ndërgjegjësuese gjatë Ditës Ndërkombëtare kundër Homofobisë dhe Transfobisë (IDAHOT) dhe Javës së Diversitetit;



Lehtësoi **kërkimet dhe hulumtimet** e studentëve të Shkencave Sociale mbi perceptimet e të rinjve për personat LGBT në shkollat e mesme, diskriminimi i vajzave lesbike në Shqipëri, martesat dhe bashkëjetesat midis personave të gjinisë së njëjtë, diferencat gjinore; qëndrimet ndaj homoseksualitetit, etj;



Finalizoi **Konkursin e Gazetarisë** dhe në bashkëpunim me Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës shpërndau tre çmime për shkrimet më të mira;

*Ambasada PINK falenderon për mbështetjen gjatë periudhës Qershor 2013 – Dhjetor 2014
Komisionin Europian, Qeverinë e Kanadasë, Ambasadën e Vendeve të Ulëta në Tiranë,
Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, Planet Romeo
Foundation dhe Këshillin e Europës.*



**Rr. Perlat Rexhepi,
Pallati ANA, Ap. 17, Kati 7
Tirane**
tel.: +355 4 2265741
e-mail pinkembassy@crca.al
www.pinkembassy.al